

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 18.03.2026

PRIMLJENO:
02/68



REPUBLIKA E KOSOVËS KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal – Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së I (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës.

Mbledhjen e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit Komunal në Malishevë, Enver Hoti. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin 12 anëtarë të Kuvendit Komunal, përfaqësues të OSBE-së, medie dhe përfaqësues nga Zyra për Informim.

Rendi i ditës

1. Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Republikën e Kosovës.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Përshëndetje anëtarë të Asamblesë Komunale në Malishevë, zyrtarë të administratës, medie. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje. Siç e dini sot jemi të thirrur në një Seancë të jashtëzakonshme me një pikë të rendit të ditës për të zgjedhur Kryesusin e Kuvendit të Komunës së Malishevës. Vazhdojmë sipas procedurës së paraparë në bazë të Statutit të Komunës dhe Rregullores. Për të vazhduar me rendin e ditës fillimisht duhet ta konstatojmë kuorumin, a kemi pjesëmarrje të mjaftueshme. Kuvendi Komunal në këto zgjedhje i ka 27 anëtarë, për ta plotësuar procedurën e rregullt duhet t'i kemi së paku 14 anëtarë të pranishëm. Ftoj administratën që ta konstatojë kuorumin sa jemi në sallë të pranishëm.


Zyrtari ligjor, **Muharrem Morina**: I nderuar kryesues konstatoj se të pranishëm janë 12 anëtarë të asamblesë.

Kryesus i mbledhjes, **Enver Hoti**: Atëherë për arsye të mungesës së kuorunit kjo Seancë do të shtyhet për afatin tjetër. I ftoj të gjitha subjektet politike që të organizohen dhe t'i përfundojnë detyrat e tyre me përgjegjësi, dhe mbi bazën e asaj për çfarë jeni zgjedhur këtu si përfaqësues. Ju falënderoj juve që keni marrë pjesë – shihemi në një Seancë tjetër, ku uroj të organizohet më shpejt që t'i japim drejtim zhvillimit të punës sonë, ashtu siç e presin qytetarët.

Mbledhja mbaroi në ora: 10:40

Procesmbajtësja:

Argenitë Thaçi



Vazhdimi i mbledhjes së I (parë) të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal të Malishevës.
Mbajtur, më 31.12.2025 duke filluar në ora: 14:20.

**Mbledhjen e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit Komunal në Malishevë, Enver Hoti.
Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Kryetari i Komunës, Ekrem Kastrati; 24 anëtarë
të Kuvendit Komunal, përfaqësues të OSBE-së, medie, përfaqësues nga Zyra për Informim.**

Rendi i ditës

1. Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.
2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Republikën e Kosovës.

Kryesus i mbledhjes, **Enver Hoti**: Përshëndetje kryetar dhe ju anëtarë të Asamblesë mirë se keni ardhur, ju uroj suksese të gjithëve. Siç e dini dje kemi pasur mbledhjen e parë të jashtëzakonshme të paraparë sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës dhe Rregullores së Kuvendit Komunal, por në mungesë të kuorumit është ndërprerë Seanca. Sot qenkeni mbledhë të gjithë, dhe do të vazhdojmë me procedurën sipas rendit të ditës. Para se të kalojmë te rendi i ditës vazhdojmë me disa procedura, të cilat na obligojnë për ta vërtetuar kuorumin dhe njëherë. Po i thërras me emër të gjithë dhe konstatojmë kush është i pranishëm dhe kush jo.

Nisma Socialdemokrate

Halil	Morina
Remzi	Hoti,
Hafir	Rexha
Avdi	Morina
Amrush	Helshani
Gentiana	Mehmeti
Edonë	Hoti
Bashkim	Berisha
Gazmend	Begaj
Sylë	Dukolli (<i>nuk ka qenë i pranishëm</i>)
Valbona	Morina
Bashkim	Krasniqi
Rukije	Bytyçi (<i>nuk ka qenë e pranishme</i>)

PDK

Mevludin	Mazreku
Burim	Paçarizi
Demir	Bajra
Imran	Xhyliqi
Valjetë	Hoti
Mërgime Robaj	Gashi

LDK

Fatmir	Ademaj,
Xheneta	Morina
Fitim	Shala
Egzonë	Paqarizi (<i>nuk ka qenë e pranishme</i>)

LVV

Veton	Zogaj
Arben	Krasniqi
Vlera	Bytyçi

AAK

Enver	Hoti
-------	------

Kryesus i mbledhjes, **Enver Hoti**: Sipas leximit të emrave, mungojnë tre përfaqësues të Asamblesë, 27 janë gjithsej dhe mund të konstatojmë që prezent janë 24 anëtarë. Kemi kuorum për vazhdim të mbledhjes: vazhdojmë me pikën e rendit të ditës e cila është:

Formimi i komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit, konform Udhëzimit Administrativ nr.2009/01, për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesusit të Kuvendit të Komunës.

Ftoj partitë që t'i propozojnë emrat e anëtarëve për ta formuar komisionin për mbarëvajtje të këtij procesi. Nuk dua që të kemi keqkuptime nga subjektet politike. A jeni të pajtimit që t'i ketë tre përfaqësues ky komision?

A ka dikush për të thënë ndonjë gjë në lidhje me propozimin tim? Nëse jo, kush është që komisioni t'i ketë 3 anëtarë?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenime: 3

Me 21 vota **Për**, 0 **Kundër**, 3 **Abstenime** miratohet propozimi që komisioni t'i ketë tre anëtarë.

Ftoj Halilin që ta bëjë propozimin e grupit të tyre.

Halil Morina, nga **Nisma Socialdemokrate**: Në emër të Grupit Parlamentar **Nisma** për komisionin për mbarëvajtje të procesit të votimit për Kryesues, propozojë **Amrush Helshanin**.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Urdhëro, Mevludin Mazreku!

Mevludin Mazreku, anëtarë nga **PDK**: Në emër të subjektit tonë politik propozojmë, **Imran Xhyliqin**.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Urdhëro, Fitim Shala!

Fitim Shala, anëtarë nga **LDK**: Përshëndetje për të gjithë! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e propozojmë, **Xheneta Morinën** për anëtare të komisionit.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: A jeni të pajtimit që këta tre emra: **Amrush Helshani**, **Imran Xhyliqi**, **Xheneta Morina** të jenë anëtarë të komisionit për mbarëvajtje të procesit të votimit për Kryesues të Kuvendit të Komunës? Kush është për?

Për: 21

Kundër: 0

Abstenime: 3

Me 21 vota **Për**, 0 **Kundër**, 3 **Abstenime** formohet komisioni për mbarëvajtje të procesit të votimit për Kryesues të Kuvendit të Komunës. Ftoj anëtarët e komisionit që t'i marrin detyrat dhe të përgatitën për të kaluar në pikën e dytë të rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës e cila është:

Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, konform nenit 41 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale në Republikën e Kosovës.

Ftoj grupin më të madh në Asamble **Nisma Socialdemokrate** nëse kanë propozim.

Urdhëro, Halil Morina!

Halil Morina, anëtarë nga **Nisma Socialdemokrate**: Grupi i **Nisma-s** nuk ka propozim për Kryesues të Kuvendit të Komunës.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Ftojë **PDK**-në nëse kanë propozim për Kryesues të Kuvendit?

Burim Paçarizi, anëtarë nga PDK: Përshëndetje për të gjithë!

Ne si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike kemi një propozim, propozojmë kandidaten për Kryesues të Kuvendit, **Valjetë Hoti**.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Ftoj LDK-në nëse kanë propozim për Kryesues të Kuvendit?

Fitim Shala, anëtarë nga LDK. Grupi parlamentar i LDK-së ka propozim, propozojmë: **z.Fatmir Ademaj** kandidat për Kryesues të Kuvendit Komunal në Malishevë.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Ftoj LVV-në nëse kanë propozim për Kryesues të Kuvendit?

Veton Zogaj, anëtarë nga LVV: Përshëndetje për të gjithë!

Ju uroj të gjithëve shëndet dhe suksese. Më vjen çudi se si grupi më i madh politik nuk ka propozim, është hera e dytë që po veproni kështu. Problemin kryesor kemi pasur me kushte pune si kuvend. Uroj që Kryesuesi i ri që del sot me votat tona si asambleistë me u marrë me punën e zgjedhjes së problemeve që i kemi si kuvend. Ne si grup nuk kemi propozim.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Jemi duke hyrë në fazën e votimit të rregullt, i kemi dy propozime: nga PDK kemi propozimin e anëtares **Valjeta Hoti**, ndërsa nga LDK kemi një propozim që si Kryesues të Kuvendit të jetë **Fatmir Ademaj**. Vazhdojmë me procedurën e votimit. Administrata të përgatitet me pjesën teknike dhe administrative për ta procedu më tutje dhe uroj që Kryesuesi të zgjidhet dhe të vazhdojmë me punën.

Muharrem Morina, Zyrtar ligjor: Për arsye se ne nuk i kemi ditur emrat se kush janë kandidatët, fletat e fletëvotimit janë të përgatitura, vetëm duhet m'i vendos emrat. Na duhen 10 minuta kohë.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Përgatitjet janë bërë po hyjmë në fazën e votimeve, secili asambleistë që e merr letrën e votimit le ta kontrollojë, a është me vullë.

Te komisioni e merrni fletën e votimit, në anën e djathtë e keni kabinën ku do të votoni, ju e dini që jemi 27 anëtarë të zgjedhur sipas ligjit, ai i cili do të zgjidhet si Kryesues duhet t'i ketë 14 vota, nëse nuk i merr në raundin e parë 14 vota *përsëritet votimi*. Nëse nuk i merr as në raundin e dytë, në raundin e tretë kalon ai i cili merr *shumicën e votave* nga të cilët marrin pjesë në votim.

Urdhëro, Amrush Helshani!

Amrush Helshani, anëtar nga Nisma Socialdemokrate: Të nderuar anëtarë të Kuvendit, në emër të komisionit verifikues për zgjedhje të Kryesuesit të Kuvendit ju njoftoj që janë bërë të gjitha përgatitjet. Prezent janë 24 anëtarë të Kuvendit, fletëvotimet janë të gatshme, dhe sipas renditjes Kryesuesi i kësaj mbledhjeje do t'i ftojë të gjithë anëtarët e Kuvendit. Po ashtu siç po e shihni arka është e zbrazët ne jemi të gatshëm për të filluar këtë proces për zgjedhje të Kryesuesit.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Vazhdojmë me procedurën e votimit.

Nisma Socialdemokrate

Halil	Morina
Remzi	Hoti,
Hafir	Rexha
Avdi	Morina
Amrush	Helshani
Gentiana	Mehmeti
Edonë	Hoti
Bashkim	Berisha
Gazmend	Begaj
Sylë	Dukolli (<i>nuk ka qenë i pranishëm</i>)
Valbona	Morina
Bashkim	Krasniqi
Rukije	Bytyçi (<i>nuk ka qenë e pranishme</i>)

PDK

Mevludin	Mazreku
Burim	Paçarizi
Demir	Bajra
Imran	Xhyliqi
Valjetë	Hoti
Mërgime Robaj	Gashi

LDK

Fatmir	Ademaj,
Xheneta	Morina
Fitim	Shala
Egzonë	Paqarizi (<i>nuk ka qenë e pranishme</i>)

LVV

Veton	Zogaj
Arben	Krasniqi
Vlera	Bytyçi

AAK

Enver	Hoti
-------	------

Amrush Helshani, anëtar nga **Nisma Socialdemokrate**: Të dashur anëtarë të Kuvendit konstatojmë se pjesëmarrës në votim kanë qenë 24 anëtarë. Të gjitha fletëvotimet janë të vlefshme.

Me 14 vota **Për** zgjedhet Kryesues i Kuvendit **z.Fatmir Ademaj!**

Ndërsa kandidatja **Valjetë Hoti** ka 10 vota.

Në emër të këtij komisioni ju përshëndesim dhe ju falenderojmë për kontributin.

Kryesus i mbledhjes, **Enver Hoti**: Faleminderit të gjithë juve që keni marrë pjesë në këtë proces të votimit. Në emër tuaj dhe në emër të qytetarëve të Komunës i uroj punë të mbarë **z.Fatmir Ademaj!** I gjithë ky potencial është përfaqësim i qytetarëve të Komunës së Malishevës dhe të jetë në orientimin dhe rrugën e mbarë për zhvillim dhe ecje përpara.

Fjalën e ka **z.Fatmir Ademaj!**

Fatmir Ademaj, anëtar nga **LDK**: I nderuar kryesues,

Të nderuar qytetarë të Komunës së Malishevës. I falënderoj të gjithë qytetarët e Komunës së Malishevës për besimin e dhënë për të gjitha subjektet politike, për një kulturë demokratike në zgjedhjet lokale. Unë si Kryesues i Kuvendit do të mundohem të bashkëpunoj me të gjitha grupet parlamentare, për arsye se këtu jemi përfaqësues të qytetarëve të Komunës së Malishevës. Kuvendi i Malishevës është institucioni më i lartë së bashku me Kryetarin e Komunës, në të cilin duhet të shtjerren të gjitha debatet për të mirë të qytetarëve të Komunës së Malishevës. Të nderuar asambleistë faleminderit për besimin e dhënë, do të jem i përgjegjshëm dhe do mundohem të punoj për të mirën e qytetarëve të Komunës së Malishevës. Faleminderit të gjithëve!

Kryesus i mbledhjes, **Enver Hoti**: Urdhëro, Mevludin Mazreku!

Mevludin Mazreku, anëtarë nga **PDK**: Në emër të subjektit politik, të Partisë Demokratike, uroj që zgjedhja e këtij Kryesuesi të shërbejë në shërbim të qytetarëve, mirëpo si subjekt politik do të shprehim angazhimet tona në kuadër të këtij Kuvendi, duke pasur parasysh që po vazhdohet e njëjta qeverisje si në mandatin e kaluar. Ajo qeverisje e kaluar ka dëshmuar keq-qeverisje, ka dëshmuar që nuk janë realizuar premtimet, ato premtime shumë të nevojshme për qytetarët e Komunës. Subjekti politik që ka bërë Marrëveshje politike me Nismën Socialdemokrate ka dëshmuar që në mandatin sa kanë qenë në qeverisje, vetëm interesat personale e familjare i kanë realizuar te punësimet e shumta që i kanë realizur. Po ashtu dhe premtimet, projektet madhore për qytetarin e Malishevës të cilat janë: energjia elektrike, ishte projekt i dështuar i kësaj qeverisjeje komunale; ujësjellsa po ashtu një problem jetik për qytetarin e Komunës së Malishevës. Rrugët tranzite për Komunën e Malishevës dhe shumë çështje të tjera të cilat i kanë preokupuar qytetarët e Malishevës nuk janë realizuar.

Kështu që ne si subjekt politik dyshojmë në këtë përbërje të re. Ne do të jemi konstruktiv së bashku me bashkëpunorët e tjerë të opozitës dhe do t'i qëndrojmë besnik PDK-së. Shfrytëzoj rastin që qytetarëve të Komunës së Malishevës tua uroj festën e Vitit të Ri dhe shpresojmë që viti 2026 të jetë më i mirë për të gjithë!

Kryesus i mbledhjes, **Enver Hoti**: Urdhëro, Veton Zogaj!


Veton Zogaj, anëtarë nga LVV: Po ndihem i dëshpëruar që sot e patën mundësinë kolegët tonë të Asamblesë me votu një femër si Kryesuese të Kuvendit. Në krejt fushatën zgjedhore kanë folur për barazi gjinore, për mbrojtjen e të drejtave të gruas, ndërsa në momentin që e qet një femër si kandidate për me udhëhequr këtë Kuvend – votojnë kundër. Të paktën ta kishit bërë formale këtë Marrëveshje politike, por që 4 vjet keni vazhduar njëjtë. Unë nuk kam asgjë personale me askënd, të paktën eja në Kuvend me kohë dhe thuaj: po kam Marrëveshje politike zyrtare dhe jam si kandidat për Kryesues të Kuvendit, por mos eja këtu fshehurazi me u ulë si herave të kaluara dhe të bëjë pazar. Duhet të marrë fund kjo punë dhe vjen si anëtar ndoshta ta japim edhe ne votën. Valjetës i urojmë punë të mbarë në Kuvend dhe i them mos u dëshpëro se je vajzë e re dhe ke potencial, këtë e kemi parë dhe në mandatin e kaluar.

Kryesues i mbledhjes, **Enver Hoti**: Nëse nuk ka dikush për diskutim, kërkoj mirëkuptimin tuaj që ta shpreh një falënderim. Të nderuar anëtarë të Asamblesë dhe ju i nderuar Kryesues që sapo u zgjodhët me votën e lirë, unë e vlerësoj shumë këtë procedurë të rëndësishme dhe në emër të AAK-së juve ju urojë punë të mbarë, suksese në drejtimin e kësaj Asambleje shumë të nderuar! Falënderoj edhe stafin administrativ për shërbim dhe kushtet që na i kanë ofruar për ta realizuar këtë detyrë dhe përgjegjësi që më është dhënë. Sot u mor një vendim nga anëtarët e Asmablesë, një vendim që na lë të kuptojmë që ka një Marrëveshje politike në mes të dy subjekteve: Nisma – LDK. Uroj që kjo Marrëveshje të jetë mbrenda kuadrit programor të objektivave të atyre që e kanë fituar votën e qytetarëve. Ju bëj thirrje të gjithëve që ta luani një rol pozitiv edhe në të bërit pozitë dhe opozitë. Sot është një ditë festive, meqë m'u dha rasti me drejtu këtë Seancë ju urojë të gjithë qytetarëve të Komunës së Malishevës festën e Vitit të Ri. Këtë Seancë e shpallim të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në ora: 15:30

Procesmbajtësja:

Argenitë Thaçi



Kryesuesi i mbledhjes:

Enver Hoti

